

STATUTI

I

SHOQËRISË "ATB 2023" "SHPK"

Në Tiranë, sot më datë 17/09/2019 une,

MASSIMILIANO CORDESCHI, lindur me 20/10/1969, ne Rome,Itali , nenshtetas Italian, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, zoterues i dokumentit te identifikimit pasaporte me nr YA0793321 dhe banues ne Lago di Olgiate 15, 00123 Rome, Itali.

Në cilësinë e "ortakut themelues" kam rene dakort per nënshkrimin e ketij statuti të mëposhtëm, të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar(më poshtë shoqëria), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.

Statuti i shoqërisë është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të të, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

KREU I FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1 Forma

- Shoqëria "ATB 2023" sh.p.k_(në vijim shoqëria), krijohet në formën e një shoqërie të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij statuti.
- Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- Statuti i shoqërisë është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të të, plotësohen nga legjislacioni Shqiptar.

Neni 2 Emertimi

Emërtimi i Shoqerisë është "ATB 2023" "sh.p.k.

Neni 3 Objekti i veprimtarisë

Shoqeria "ATB 2023" shpk do te ketë si objekt të veprimtarsise së saj, konsulencë te ndryshme ligjore, fiskale, zhvillim tregu, marketing e te ndryshme ndaj kompanive te ndryshme te nivelit kombetar dhe nderkombetar. Konsulencia ju ofrohet kompanive me natyre:

- Tregtare
- Investimesh
- Prodhuese
- Promocioni
- Sherbimi
- Ndertim
- Menaxhim

Massimiliano Cordeschi
M. Corde

-Inxhinjerike
-WEB Design

Shoqeria nder te tjera mund te ofroje edhe konsulenca ne mbledhjen, perpunimin dhe analizimin e te dhenave per çdo forme apo veprimitarari me natyre fitimprurese dhe jo vetem.

Çdo operacion tjeter financiare tregtar apo industrial qe mund te lidhet drejteperdrejte ose terthorazi me një nga objektet e shoqerise.

Njekohësish Shoqëria mund të ofroj konsulenca te natyrave te ndryshme te papermendura me siper si dhe ndermjetsime te ndryshme.

Shoqeria mund te marre dhe te behet pjese e shoqerive te huaja ne formen e pronesise nepermjet aksionave, kuotave te kapitalit ose formave te ndryshme te investimit ne kapital.

Veç sa më sipër Shoqëria mund të kryeje çdo lloj aktiviteti tregtar dhe industrial, në përputhje me dispozitat ligjore të legjislacionit shqiptar dhe të huaj.

Neni 4
Selia

Shoqëria e ka selinë në Rrugën e Barrikadave, Qendra Tregtare GALERIA, Kati i Dyte, Apartamenti nr 14, Tirane. Shoqeria mund të ndryshojë selinë e saj, si edhe të hapë zyra perfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.

Neni 5
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimitarisë se shoqërisë do të për një periudhë kohore të pakufizuar.

KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali Themeltar

Kapitali i shoqërisë është 100000 (njeqind mijë) Lekë.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga një kuotë me vlerë nominale 100000 (Njeqind mijë) lekë:

Kjo kuotë kapitali është e shlyer tërësisht dhe mbajtës/ pronar i kësaj kuote është z. MASSIMILIANO CORDESCHI.

Neni 7:
Rritja e kapitali Themeltar

Kapitali Themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, me vendim të asamblesë së Ortakëve.



Në rast rritjeje te kapitalit të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë rritjen në raport me vlerën nominale të kuotës së kapitalit të zotëruar. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me vlerën nominale të kuotës së kapitalit të zotëruar prej tyre.

Neni 8:
Zvogëlimi i kapitali Themeltar

Kapitali Themeltar mund të zvogëlohet, me vendim të asamblesë së Ortakëve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji. Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me vlerën nominale të kuotës së kapitalit të zotëruar prej tyre.

Neni 9:
Transferimi i kuotave

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi te kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributin në kapitalin e shoqërisë;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashëgimisë;
- d) Dhurimit;
- e) Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rast transferimi në çdo lloj forme si me shpërblim ashtu dhe pa shpërblim në kuptimin më të gjër të fjalës duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat më parë duhet ti ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë.

Në çdo rast ortaku që do të trasnferojë kuotën e tij duhet të njoftoj ortakët e tjerë me letër rekomande me kthim përgjigje me synimin për shitje duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e trasferimit. E drejta e parablerjes duhet ti refereohet të gjithë kuotës të ofruar për shitje.

Ortakët do të kënë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja eletrës rekomande, për ti komunikuar ortakut që transferon kuotat synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.

Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuota e ofruar nga ortaku që transferon atë do të ndahet midis ortakëve pranues, proporcionalisht me vlerën nominale të kuotës së kapitalit që ata zotërojnë, përvèç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.

Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund të trasnferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, pas miratimit nga Asamblea e Ortakevë.

KREU III
VENDIMARRJA, ADMINISTRIMI

Neni 10
Organi Vendimmarrës

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm ne rast se shoqeria eshte e themeluar



nga një ortak i vetem. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e Pergjithshme vendos për çështje si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- j) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- k) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- l) investime;
- ll) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- m) te bleje, shese, kembeje pasuri te patundshme te shoqerise;
- n) per shperndarjen e fitimit.

Neni 11

E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota në proporcion me vlerën nominale të kuotës së kapitalit që ai zotëron.

Çdo ortak ka të drejtë të përfësohet nga një person tjetër jo ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën esë cilës mund të japë votën e tij.

Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kuotës që zotëron, nqs voton personalisht për pjesën e mbetur.

Neni 12

Thirrja e asamblesë së ortakëve, kuorumi, dhe Vendimet.

Asambleja e ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda gjashtë muajve nga mbyllja e vitit finanziar, për miratimin e bilancit, të raportit të administratorit, ekspertit kontabel (nëse ka), si dhe inventarit.

Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej administratorëve si dhe prej një ose prej disa ortakëve që përfaqsojnë të paktën 5% (pesë përqind), të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet tu dërgohet ortakave në adresën që rezulton sipas këtij statuti, dhe ekspertit kontabel (nëse është emëruar) të paktën 7 (shpatatë) ditë përpëra mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion në lidhje me çëshjtjet që do të trajtohen dhe do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.



Në rast se Asambleja nuk mblidhet në thirrjen e parë për mungesën e kuorumi të parashikuar të këtij statuti, Asambleja e Ortakëve do të thirret brenda 30(tridhjete) ditesh me të njëtin rend dite.

Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqsojnë të tërë kapitalin themeltar.

Vendimet e Asamblesë së Ortakëve janë gjithmonë të vlefshme nëse janë të marra dhe të zbatuara sipas parashikimeve të këtij statuti dhe parashikimive ligjore.

Neni 13
Administrimi

Administrator i shoqerise MASSIMILIANO CORDESCHI, nenshtetas Italian, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, zoterues i dokumentit te identifikimit pasaporte me nr YA0793321 , emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Neni 14
Kompetencat

Administratori ka të drejtë të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe detyrimeve të tjera ligjore,
- e) Te hape llogari bankare dhe te operoje per llogari te kompanise pa limit;
- f) te kerkonte financime pa limit per kompanine nga banka apo institucionet e tjera financiare;
- g) raportojë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e asamblesë së përgjithshme edhe ne rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përparrë të gjitha personave fizike e juridike, publike apo private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallevet. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.



Administratori angazhon shoqerinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Veç sa parashikuar më sipër administratori ka të drejtën të veprojë gjithmonë në përputhje me ligjet shqiptare në fuqi.

Neni 15
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Me përjashtim të vitit të parë financiar që fillon nga data e regjistrimit të shoqerisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

Neni 16
Bilanci i shoqerisë.

Brenda 6 (gjashtë) muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Neni 17
Dividenti-Fitimi.

Mbledhja e Asamblee se Pergjithshme të shoqerisë vendos rreth shpërndarjes së dividentit. Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor u shpërndahen ortakëve në proporcione me vlerën nominale të kuotës së kapitalit themeltar të zotëruar.

Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtzakonshme ose për qëllime të tjera apo shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, pjesërisht apo plotësisht, për vitet financiare të ardhshme.

Neni 18

Shpërndarja ose prishja e shoqerisë mund të bëhet në çdo kohë :

Shoqeria prishet në përfundim të afateve të parashikuar nga statuti, ose përpala përfundimit të këtyre afatave sipas rasteve të parashikuara në ligj, ose me anë të të një vendimi të asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndyshimet në statut.

Neni 19
Likudimi

Në rast prishje shoqeria duhet të likuidohet.


Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit të shoqerisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.

Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do ti shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcione me vlerën nominale të kuotës së zotëruar prej tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 20
Zgjidhja e mosmarrveshjeve

Për mosmarreveshjet që mund të lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si



dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis ortakut/ortakëve të Shoqerisë dhe të tretëve, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrveshjes ato do ti drejtohen për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 21
Dispozita përfundimtare


Ky statut themelimi u redaktua në 3 kopje në gjuhën shqipe, me përbajtje dhe vlera të njëjtë juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare “ATB 2023” “shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orgjinale.

Ky statut pasi u lexua nga ortaku themelues i shoqërisë, nënshkruhet me vullnetin e lirë prej tij.

ORTAKET E SHOQERISE

MASSIMILIANO CORDESCHI

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Massimiliano Cordeschi" above a stylized surname.